

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Skicimet, parametrat teknik etj:

Per kryerjen e Sherbimit me Roje Private,Autoriteti Kontraktor do te vere ne funksion te Operatorit Ekonomik fitues ,Gen-Planin e 2(dy) objekteve,ku do te kryhet ky sherbim.(Godina Klinike Dentare dhe Sherbimi Higjene –epidemiologji Durres)

Operatori Ekonomik ne kryerjen e ketij sherbimi duhet te kete personel te licensuar ,me certifikata perkatese te leshuar nga Drejtoria e Pergjithshme e Policise se Shtetit dhe Drejtoria e Policise se Qarkut perkates, ne baze te ligjit nr.75/2014 dt.10.07.2014 ”Per Sherbimin Privat te sigurise fizike ”, Udhezimit Nr.157 date 1.04.2015”Per funksionimin e Sherbimit Privat te Sigurise Fizike” te MPB,dokument identifikimit, Rojet te jene te pajisur me uniform me logon e Shoqerise,te kene radio komunikimi ,te jene te armatosur konfrom urdherit nr.155 dt.29.05.2014 .

Numri i rojeve gjithsej do te jete : 2 vend roje me 5 (pese) roje ,pra 10 roje.

Pershkrimi i kerkesave te zbatimit te sherbimeve ne lidhje me to:

Kerkesat per kryerjen e sherbimit,jane specifikuar ne Termat e References si dhe ne grafikun dhe menyren e ekzekutimit te sherbimit per ruajtjen e objekteve.Kryerja e ketij sherbimi do te behet ne menyre te tille qe objektet te ruhen ne menyre konkrete dhe pa pasoja per Autoritetin Kontraktor.

Public Health Sector

SHËRBIMET DHE GRAFIKU I EKZEKUTIMIT

Shërbimi që kërkohet:

Ruajtja me roje private i dy objekteve Klinike Dentare dhe Sherbimi Higjene-Epidemiologji,do te kryhet si me poshte:

Ne dy vend roje me nga 5 (pese)roje secili vend roje per periudhen nga lidhja e kontrates deri me 31.12.2017.

Sherbimi do te kryhet sipas ketij grafiku:

24 ore ne dy vend rojet (Turni I ,Turni II ,III) per çdo dite te javes dhe festa.

Afatet e ekzekutimit:

Me lidhjen e kontrates deri me 31.12.2017.

TERMAT E REFERENCËS

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve:

Ruajtja me roje private i dy objekteve Klinike Dentare dhe Sherbimi Higjene – Epidemiologji, sigurimi i objekteve, jetes se punonjesve, pasurise, prones dhe vlerat ,monetare

Detyrat:

Operatori kontraktues do te realizoje sherbimin ne baze te Ligjit 75/2014 dt.10.07.2014 ”Per Sherbimin Privat te sigurise fizike”, dhe Udhezimit Nr.157 date 1.04.2015”Per funksionimin e Sherbimit Privat te Sigurise Fizike” te MPB, gjithashtu per te realizuar sherbimin kontraktuesi ka per detyre:

- Sigurimin e jashtem te te gjithe territorit te objektit (te percaktuar me siper) nga çdo tentative e veprim keqberes ndaj tij, pasurise materiale e monetare, si dhe garanton jeten e punonjesve.
 - Do te zbatoje me perpikmeri kerkesat qe do te kete nga ana e D.R.SH –Dures dhe do te informoje ne kohe çdo shkelje qe do te konstatoje.
 - Per çdo ngjarje te ndodhur si vjedhje, grabitje, demtim apo shkaterrim te objektit apo prones i ardhur si pasoje e moskryerjes se detyres nga ana e rojeve private, kontraktuesi merr persiper likuidimin e demit ne masen 100 % ne favor te DRSH Dures.
 - Ne rast zjarri ne territorin e objektit ose ne objekt do te informohet sherbimi zjarrfikes, roja i objektit te perdore pajisjet zjarrfikese te vendosur ne objekt, si dhe te ndihmoje sherbimin zjarrfikes per shuarjen e zjarrit.
 - Per veprat kriminale qe mund te ndodhin do te bashkerendoje sherbimin ne objekt me Drejtorine e Policise Qarkut dhe Organet e drejtesise
- Në vend roje duhet të jenë këto dokumenta:

- a-Rregullorja e brendshme
- b-Libri i marrjes në dorëzim të shërbimit.
- c-Grafiku i shërbimit.
- d -Mjete ndriçimi në rast mungese energjije elektrike

e- Numrat telefonik të rajonit të policisë, zjarrfikseve dhe të personave kryesorë përgjegjës të objektit.

Shpërndarja:

Objektet ku do të realizohet shërbimi me roje private janë godina e Klinikës Dentare dhe godina e Shërbimit të Higjenes dhe Epidemiologjisë. Shpërndarja do të bëhet sipas turneve, për të siguruar mbulimin e tyre me shërbimin e rojeve pa ndërprerje gjatë gjithë periudhës nga lidhja e kontratës deri më 31.12.2017.

Vendi i kryerjes së shërbimeve:

Objektet ku do të realizohet shërbimi me roje private ndodhen në Durrës, Lagja nr.4, në godinat Klinike Dentare dhe Shërbim Higjens -Epidemiologji

